

2675 09.09.2026

Shkolla e Mesme Profesionale "Hoxhë Kadri Prishtina" dhe "Minatori" Fushë Kosovë

Në bazë të U.A nr.02/2016 të datës 12.01.2016 të MASHT-it, Drejtoritë e Shkollave të Mesme Profesionale në Fushë Kosovë morën vendim të shpallin këtë:

FTESË-OFERTË

Për realizimin e ekskursionit të maturantëve të Shkollave Profesionale - Fushë Kosovë

Ftohen Agjencitë Turistike që të marrin pjesë në transportimin dhe akomodimin e 140 maturantëve të Shkollave të Mesme Profesionale në Fushë Kosovë në Republikën e Shqipërisë në kohëzgjatje prej 5 (pesë) ditëve e 4 (katër) bujtjeve.

Në ofertë të parashihet çmimi i akomodimit, ushqimit, transportit dhe shpenzimeve të ndryshme që paraqiten me rastin e vizitave.

Agjencioni për ekskursion duhet të plotësoj këto kushte:

1. Operatori ekonomik duhet të ketë licencën sipas ligjit mbi transportin me të drejtë qarkullimi jashtë shtetit - ofertës t'i bashkangjiten fotokopjet e këtyre dokumentave (të verifikuara te noteri),
2. Të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve dhe në pronësi të veten,
3. Autobusët të kenë kontrollimin teknik sipas procedurave ligjore me certifikata të lëshuara nga Ministria,
4. Autobusët duhet të jenë komfor dhe me klimë,
5. Agjencioni duhet të sigurojë mjekun (çertifikatë pune dhe diplomë të mjekut),
6. Rezervimi dhe konfirmimi i hotelit me dëshmi origjinale e të vulosur,
7. Agjencioni duhet të ketë dokumentacionin (licencën) e agjencionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve (licenca të jetë e vërtetuar edhe nga pronari i hotelit),
8. Të i përmbahet itinerarit të realizimit të ekskursionit, i përpiluar nga Këshilli Drejtues i Shkollës,
9. Ekskursioni planifikohet të realizohet brenda datave **21.09.2026** deri më datën **30.09.2026**.
10. Dokumentet e pakompletura nuk shqyrtohen.

Konkursi është i hapur 7 ditë kalendarike, prej ditës së shpalljes në web faqen zyrtare të komunës.

Oferta mbetet e hapur prej datës 09.09.2026 deri me datën 17.09.2026 në ora 12:00.

Dokumentet e kompletuara dorëzohen tek Sekretari i Shkollës Profesionale "Hoxhë Kadri Prishtina" në Fushë Kosovë.

Hapja e ofertave bëhet me datën 17.09.2026 në ora 12:10 nga komisioni, pa praninë e operatorëve. Fituesi i ofertës do të njoftohet përmes telefonit ose e-mailit si dhe do të publikohet në web faqen zyrtare të Komunës së Fushë Kosovës.

Fushë Kosovë: 09.09.2026

U.d i drejtorit: Arben Simnica

Zv.drejtör : Ukshin Uka

